

VENDIM
Nr. 7, datë 10.6.2014

PËR NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 2, DATË 9.4.2014, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, “PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE, THIRRJA E PARË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në listën nr. 1, që i bashkëlidhej vendimit nr. 2, datë 9.4.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhen ndryshimet, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga fondet e padetajuara për infrastrukturën vendore nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2014.

3. Ngarkohet ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	anëtar
Ministri i Financave	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar
Ministri i Shëndetësisë	anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar
Ministri i Kulturës	anëtar
Ministri i Mjedisit	anëtar
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar

SHTOJCA I

Lista 1: Projektet e infrastrukturës vendore, thirrja e parë

Projekti nr. 25 i listës ndryshon si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Vlera për financim 2014
Qarku Fier				
25	Bashkia Divjakë	Shëtitore rruga Divjakë - Pisha	46,000,000	34,800,000

Projekti nr. 29 i listës ndryshon si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Vlera për financim 2014
Qarku Gjirokastrë				
26	Bashkia Gjirokastrë	Shëtitoret Gjirrokastër, Parku i Viroit (pedonale, ndriçim etj.)	251,000,000	159,662,318

